



Kuvendi i Komunës së Gjakovës
01 Nr. _____/2022
Datë: 07.02.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, Nenin 18 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së pa Luajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.02.2022 pas diskutimit lidhur me pikën e 8 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për Themelimin e Komisionit për shqyrtimin e Ankesave të Palëve në Procedurën e Dhënies në Shfrytëzim të Pronës Komunale, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Procedurën e Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale në Komunën e Gjakovës, me këtë përbërje :
 1. Z. Gjevalin Nikollbibaj, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
 2. Znj. Eranda Kumnova-Baçi, përfaqësuese e Ekzekutivit të Komunës .
 3. Z. Valon Pnishi, përfaqësues i Kuvendit të Komunës .
 4. Z. Liridon Dula, përfaqësues i Kuvendit të Komunës .
 5. Znj. Nora Kulludra, përfaqësuese e sektorit jo qeveritar .
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .
3. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Anëtareve të Komisioni
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Znj. Arbënësja Kuqi